



BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2012

LËNDA: SOCIOLOGJI

VARIANTI A

E shtunë, 30 qershor 2012

Ora 10.00

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20 pyetje**.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Studioni situatën dhe përgjigjuni pyetjeve nr. 1, 2, 3 dhe 4:

Një nga grupet e punës për regjistrimin e popullsisë shkoi në dy familje.

Familja e parë sapo ishte sistemuar në qytet. Pjesëtarët e familjes po përpiqeshin të gjenin punë. Kur shkoi grupi i punës së regjistrimit të popullsisë në familjen e parë u prit nga i zoti i shtëpisë, një burrë i thyer në moshë. Çdo punë në shtëpi u ndërpre dhe të gjithë u angazhuan për të pritur sa më mirë grupin e punës. Kur e mbesa, gjimnaziste, guxoi të flasë, ai e pa me inat dhe vajza heshti. Vëllai i saj më i vogël, nuk pyeste për rregulla të tilla. Një shikim i tillë për të, nuk do të kishte asnjë ndikim në sjelljen e tij, e cila nuk dëmtonte askënd.

Familja e dytë ku shkoi grupi i regjistrimit, ishte shpërngulur nga qyteti në fshat. Dy prindërit merreshin me punë krijuese: kryefamiljari ishte profesor i shquar dhe i biri ndiqte studimet e larta. Ata dëshironin të jetonin në një ambient të qetë e të pastër, pa u larguar nga veprimtaria e tyre në qytet.

1. Familja e dytë është: **1 pikë**
 - A) patriarkale
 - B) e mbyllur
 - C) e hapur
 - D) moderne

2. Shpërngulja e familjes së profesorit të shquar lidhet me dukurinë urbanistike të: **1 pikë**
 - A) xhentrifikimit
 - B) eksurbanizimit
 - C) përtëritjes urbane
 - D) shpërqendrimit urban

3. Në fragmentin: "...Vëllai i saj më i vogël, nuk pyeste për rregulla të tilla. Një shikim i tillë për të, nuk do të kishte asnjë ndikim në sjelljen e tij, e cila nuk dëmtonte askënd.." bëhet fjalë për: **1 pikë**
 - A) folkuej
 - B) more
 - C) tabu
 - D) vlerë

4. Grupi i punës për regjistrimin e popullsisë po kryen: **1 pikë**
 - A) studim sociologjik
 - B) eksperiment sociologjik
 - C) intervistë gjysëm të strukturuar
 - D) intervistë të lirë

5. Cili pohim nuk është funksion i deviancës: **1 pikë**
 - A) sjelljet deviante dëmtojnë solidaritetin shoqëror
 - B) sjelljet deviante përcaktojnë kufijtë moralë
 - C) sjelljet deviante janë burim ndryshimesh
 - D) sjelljet deviante përforcojnë vlerat ekzistuese

6. Kategoria e njerëzve me disa karakteristika fizike ose kulturore, të cilët i dallojnë nga anëtarët e tjerë që përbëjnë shumicën e shoqërisë quhen: **1 pikë**
- A) pakicë (minoritet)
B) etnicitet
C) racë
D) asimilim
7. Ndryshimi i pozitës shoqërore të individëve brenda një sistemi të shtresimit shoqëror quhet: **1 pikë**
- A) ndryshim shoqëror
B) lëvizje shoqërore
C) lëvizshmëri shoqërore
D) shtresim shoqëror
8. Shekullarizimi është: **1 pikë**
- A) organizatë fetare konservatore, që përpiqet të restaurojë elementët themelorë të fesë
B) dobësimi i ndikimit dhe i rolit të besimeve fetare në shoqëri
C) lëvizje fetare për përhapjen e një besimi të panjohur
D) organizatë fetare e lidhur zyrtarisht me shtetin
9. Karakteristikat kryesore të punës në shoqëritë më të urbanizuara janë: **1 pikë**
- A) rritja e rëndësisë së profesioneve shumë të kualifikuara
B) pakësimi i peshës specifike të të vetëpunësuarve
C) shkurtimi i personelit dhe punësimi i përkohshëm i tyre
D) të gjitha alternativat.
10. Sipas Peter Berger, në shoqërinë moderne: **1 pikë**
- A) bashkësitë e vogla tradicionale veniten
B) bashkësitë e vogla tradicionale forcohen
C) varfërohet spektri i shumëllojshmërisë shoqërore
D) pakësohet mundësia për zgjedhje vetjake
11. Tregoni nga një tipar të: **3 pikë**
- a) intervistave të lira _____
- b) intervistave të strukturuar (me pyetje të përcaktuara) _____
- c) kampionimit me kuota _____
12. Shpjegoni: **3 pikë**
- a) shokun kulturor _____
- b) dy rrjedhoja të etnocentrizmit
1. _____
2. _____
13. Tregoni dy shembuj të krimit të “jakave të bardha”: **2 pikë**
- a) _____
- b) _____

- 14.** Shpjegoni nga dy tipare për secilën teori që analizon deviancën: **4 pikë**
- a) teoria biologjike
1. _____
2. _____
- b) teoria sociologjike
1. _____
2. _____
- 15.** Listoni tre nga objektivat ose parimet e lëvizjes feministe: **3 pikë**
- a) _____
- b) _____
- c) _____
- 16.** Jepni përcaktimin sociologjik për konceptin: **3 pikë**
- a) paragjykim _____
- b) diskriminim _____
- c) stereotip _____
- 17.** Përshkruani tre funksione kryesore të besimeve fetare. **3 pikë**
- a) _____
- b) _____
- c) _____
- 18.** Shpjegoni lëvizjet shoqërore: **3 pikë**
- a) alternative _____
- b) reformuese _____
- c) revolucionare _____
- 19.** Listoni tre veçoritë kryesore të shoqërisë moderne: **3 pikë**
- a) _____
- b) _____
- c) _____
- 20.** Analizoni prirjet kryesore të zhvillimeve urbane pas Luftës së II Botërore, si: **3 pikë**
- a) shpërqendrimi urban _____
- b) përtëritja urbane _____
- c) xhentrifikimi _____